

BORA BALAJ

Nën hijen e lisit

Bora Balaj

Nën hijen e lisit

poezi

©

2025



Bora Balaj

Nën hijen e lisit

poezi

Redaktor: Trandafire Malshi

Përatitja kompjuterike: Sokol Demaku

©

Botues:


Shoqata-Föreningen
Sokol Demaku
Bokförlag - Shtëpia Botuese

Kola284@gmail.com

Shtypëi Prishtinë

© 2025 Copyright @ Bora Balaj

ISBN 978-91-986676-3-9



Një lajm që vjen kaq bukur dhe me një diapazon të gjerë tematikash brenda këtij vëllimi poetik që vjen nga poetja Bora Balaj .Duke udhëtuar nëpër vargjet e saj të duket se je ulur këmbëkryq dhe po shfleton e po lexon vargje që përcjellin temaika të llojeve të ndryshme ..Kështu ajo me mjaft stil trajton tematika dhe motive të ndryshme si: Krenarinë dhe atdhedashurinë për vendit e vet duke e trajtuar dhe me elemente të tjera të trashëgimisë kombëtare ,si veshje dhe ornamente të saj. Ajo trajton dhe tematikën e gruas shqiptare si një njeri me një forcë dhe besim të jashtëzakonshëm. E gjejmë autoren duke folur për dukuri të tjera të jetës që e mbajnë gjallë njeriun, si dashuria për prindërit dhe për jetën, miqësia, familja etj Po ashtu autorja trajton dhe tematikën e njerëzve që skanë vlerë dhe shtiren gjatë jetës së tyre.

Ajo me një bukuri të pamatë vargjesh si dhe mjaft lirshmëri dhe figuracion të pasur shprehet:

**Shqiptar i vjetër i lashtë si dheu, këtu kemi mbetur,
rrënjë e gurëve, në dheun e thyer.**

Ja pra!E si do ta thoshte më ndryshe autorja këtë ? Shqiptar i vjetër, ilashtë .Dhe këtë nuk e thotë vetëm ajo por e thotë historia ,e thonë studiues ,e thotë gjithkush se ne kemi fakte që vërtetojnë bazën historike dhe lashtësinë e kombit

tonë.Ndër shekuj të largët dhe deri në ditët tona ne gjithmonë do të jemi krenar për historinë dhe lashtësinë e kombit tonë. Edhe pse me vuajtje dhe sakrifica ,ndër lufta dhe beteja ne jemi prapë bijtë e shqiptarit që kurrë nuk u trembëm as nuk u tutëm .Në cdo vatër shqiptare skuq flamuri i sakrificave dhe krenarisë sonë të ligjshme .Në muret e odave qëndron krenar përvec sharkisë a ciftelisë dhe flamuri kuq e zi që kurrë nuk u turpërua nga askush. Bashkë me to ndër vite udhëtojnë dhe traditat dhe veshjet që autorja i vë në dukje me vargje domethënëse dhe plot sharm e muzikalitet.

Autorja shkruan kaq bukur për ata njerëz që cdo ditë sjellin kaq ëmbëlsisht pjesë nga trashëgimia jonë duke kujtuar djepin që përkundi dhe rriti me qindra djem e vajza edhe pse ndër flakët e luftës dhe të sakrificës .Edhe pse ishte një djep që kobet e luftës e dogjën dhe e përzhitën prapë se prapë ai mbetet djepi i vjetër dhe autokton që rriti dhe burroi trima .Bashkë me atë djep autorja përmend dhe elemente të krenarisë kombëtare sic është dhe xhubleta e bekuar e Malësive.Ajo veshje shpreh një copë historie me kujtime,shpresë,dhimbje dhe krenari.Me vargjet e saj të fuqishme asaj i rrëzëllen shpirti dhe fytyra dhe në shpirt i lindin mijëra shpresa që do të rriten cdo ditë sepse është një shpirt i bukur që i mëkon dhe i rrit brenda tyre .Autorja në poezinë e saj cdo element të trashëgimisë kombëtare e merr në dorë dhe e mbrun me vargje që flasin për flamurin ,krenarinë,trashëgiminë,veshjet ,gëzimin dhe shpresën që rritet cdo moment në sytë dhe në zemrën e saj .Ajo tregon mjaft mirë dhe punën që ajo ka bërë për të mbledhur dhe

evidentuar vlera të tilla kombëtare dhe reale .Puna e saj e vazhdueshme për të mbledhur copëza të historisë shqiptare e bëjnë autoren të ndihet krenare.Ja se si shprehet ajo ;

Tash e 25 vite mbledh histori të gjalla, veshje kombëtare që flasin pa fjalë. Në secilën fije, një rrënjë shqiptarie, në secilin ornament një ëndërr lirie.

Cdo element i trashëgimisë popullore autorja e shtjellon dhe i jep një vend në piedestalin e kohës. Aty gjendet flamuri, xhubleta, çiftelia a sharkia, plisi dhe veshja popullore që e bëjnë që ajo të jetë krenare më cfarë përfaqëson dhe mbledh me duart e veta. Puna e saj është e jashtëzakonshme sepse mbledh dhe ruan copëza të kujtimeve dhe të historisë së kombit të vet.

Përveç motiveve atdhetare që janë të dukshme dhe domethënëse tek ky libër, autorja një sërë poezish ja kushton gruas.

**Nuk kërkove azgje, vec një botë për fëmijët e tu ,
Dhe dritën që burrat e tu spatën fat ta shihnin
Ti je hija që mbetet ,ajo që askush s’e shuan ,
Grua e pathyer, që bën jetë me shpirtin tënd të gjallë .**

Me një lumë fjalësh që flasin për një ndjenjë të fortë vlerësimi dhe autorja e quan gruan të pathyeshme sepse në cdo lloj situatë ajo lufton dhe nuk përulet për bijtë e vet.Duke udhëtuar mes vështirësish edhe pse burrat asnjëherë nuk arritën t’ia dallojnë dritën që shpërndahet nga qenia jote .

Edhe pse gjithmonë duke luftuar ajo kurrë nuk u ndal që të mendojë për vete por gjithmonë duke luftuar fort për fëmijët e vet .Një grua e cila gjithmonë sakrifikon dhe zgjedh fëmijën para vetes .Në mënyrë të veçantë i kushton një krijim të bukur gruas së Mirditës me gjithë sharmin dhe zhdërvjelltësinë e një vargu që të mban mbërthyer ,që të josh dhe fton të futesh në botën e madhe të gruas kreshnike ndoshta dhe asaj lokes që tundi djepat dhe rriti bijtë kreshnikë për ti bërë gati për luftë. Bashkë me gjirin ajo u dha dhe mësimin, lutjen dhe krenarinë e forcën për ta dashur dhe për ta mbrojtur trollin e shqipes.Në shpirtin e saj gjendet dhe ajo kënga e bukur e shqiptarit që nuk u dorëzua kurrë ,dhe ajo krenaria shqiptare tek sheh flamurin që valëvitet krenar.

Autorja si një njeri që ka përjetuar kohët e zymta të luftës në Kosovë i kushton vargje asaj kohe që ka evidentuar heronj dhe njerëz që vendit i dolën zot dhe ia shkruan historinë e lavdishme me shkronjta të arta .

Në cdo shkronjë dhe varg të autores rrjedh bota e pasur e saj që heton dhe vëzhgon dukuri dhe momente .Ajo shkruan për dukuri të jetës që e frymëzojnë por dhe i ngjallin nostalgji si shtëpia ,familja prindërit dhe jeta në përgjithësi .

Ashtu sic fluturon blea lule më lule dhe autorja kujdeset dhe shkruan për shumëçka duke na dhënë pamje dhe momente të ndryshme të jetës së saj .Me një figuracion të pasur ,me fjalor të pasur ajo arrin të na servirojë krijime plot me vlera dhe mesazhe të qarta .

Me shpirtin e saj të lirë dhe të bukur ndalet lule më lule dhe prek realitete dhe ngjarje .Ajo shkruan dhe flet ,këndon dhe kërcen në pistën e gjerë të poezisë por dhe të narrativës së përzgjedhur me një stil të ngjeshur dhe plot me kuptim .

Bashkë me dukuritë e përditshme të jetës ajo shpalos me plot pathos atdhedashurinë dhe krenarinë kombëtare .Ajo duket se e mban gjallë dhe e personifikon fakti se pasioni i saj e mban gjallë dhe e identifikon si bijë e shqiptarit që krenarinë e ligjshme ta ketë gjithmonë udhërrëfyesen më të mirë .

NËN HIJEN E LISIT

Nën hijen e lisit, ku fëshfërin koha,
u ula të flas me dashurinë,
me atë që vjen si fllad në pranverë,
por mbetet si prush kur fryn dimër i zi.

E pashë në rrënjët që mbajnë këtë trung,
të gdhendur nga stuhitë,
si duart që dhurojnë e s'kërkojnë,
si zemrat që digjen, por s'bëhen hi.

Dashuria s'është veç lule që çel,
as premtim i thënë në prag të agimit,
është hap që ecën mbi rrugë me gurë,
është dritë që s'shuhet, edhe në ikje.

Sa herë kam parë të rinjtë të enden,
me ëndrra të bardha në sytë e pastër,
dhe pleqtë që ulen mbi pragun e heshtur,
me kujtime që flasin, me zemra që digjen.

E di... dashuria ka dhe sakrificë,
është pritja e gjatë në net të vetmuara,
është dora që fshin lotin pa fjalë,
është krahë që rri edhe kur bota rrënohet.

Por nën hijen e lisit, unë e di mirë:
Ajo që jepet, s'është kurrë e humbur,
dhe ata që duan me shpirt të pastër,
janë rrënjë të forta që koha s'i shkul.

BALADA E MËNGJESIT TË PAARRIRË

Nëpër dritën e agimit të largët,
Vjen zëri yt si jehonë.
Si era që kalon malet,
Mbi dallgët që prishin gjumin aty në natën vonë .

Sa herë zbardhet dita,
Mendoj duart e tua që mungojnë,
Mëngjeset tona të pambaruara ,
Prej kohësh humbur netësh trishtojnë .

Të kam brenda si një stinë e paprekur,
Si një copëz e mbetur pranvere.
Gjithmonë e kthjellët në kujtimet e mia,
Dhe kur vjeshta mbulon çdo gjurmë me gjethe.

Këtu larg, e ndjej si rrah zemra jote,
Ashtu e fortë, fjalë e pathënë.
Në një heshtje që na mban të lidhur
Si dy valë të ndryshme, në të njëjtin oqean.

Do vij një ditë kur do të shoh sytë e tu,
Dhe asnjë natë s'do të na ndalë më.
Deri atëherë, rri e pres me shpresë,
Teksa do të vijë ai i ëmbli mëngjes .

Nëpër dritën e agimit të largët,
Vjen zëri yt si jehonë,
Si era që kalon malet,
Mbi dallgët që gjumin ma zgjon .

SHQIPTAR I VJETËR, I LASHTË SI DHEU

Shqiptar i vjetër, i lashtë si dheu,
Këtu kemi mbetur, rrënjë e gurëve, në dheun e thyer.
Me këngën e maleve në buzë, e dallgët që rrahin si flamur,
Mbartim mbi shpatulla shekuj, si peshë e si nder.

Furtunash , që të tjerët s'i përballuan,
Me duar të zhveshura, me zemra të çelikta,
Kurrë s'u dorëzuan.

Gjithë dialektet si gurgullima e një lumi të trazuar, Por
në një gjuhë, një shpirt, një zemër, i pandarë.
Nga fise të thella, me emra si tinguj të epokës së moçme, Çdo
vatër e jona një përrallë,
Çdo mal një kujtesë e fortë.

Kemi besë, si fjala e natës së qetë që nuk thyhet, Dhe
nderin si zjarr, që në asnjë stinë nuk shuhet. Traditë
që na thur kostume të lashta,
Me dorë e me shpirt,

Me ngjyra që flasin për male, fusha, e dhimbje që s'ka dritë.
Xhubleta që peshon si kujtesë e përhershme e fisit,
Si shenjë e së kaluarës sonë, mes epokave të historisë.

Jemi shqiptarë, me zemër të fortë si rrënjët në gur, Me
histori që s'ka fund, qëndron plot me nur.
Në fjalë, në këngë, në refrene të pakënduara
Jemi gjithmonë, të pandryshuar e të ndriçuar.

TRASHËGIMI E ZEMRËS (PERSIATJE ARTISTIKE)

Një ditë, më trokiti një shpirt bardhë në derë, me paje të nuserisë së saj në duar, si kujtim, si amanet, si dashuri e heshtur që ecën përtej brezave, përtej kohëve të largëta.

Një paje që kishte fjetur me ëndrra të ëmbla, ku kishin zënë vend shpresat e saj, gëzimet, dhimbjet, e një djep, i vjetër, ku të shtatë fëmijët ishin rritur, si unë dikur, në djepin që humba mes flakëve të luftës.

Ajo më dha me duar të dridhura atë kujtim të shenjtë, e unë, mes lotëve, kujtova nënën, vëllezërit e motrat e mia, në atë djep që s'e pata më, të djegur nga kobi i luftës, një kujtim i cili vetëm në zemër më mbeti.

U mallëngjeva për djepin e vjetër që s'e preka më, por në duart e mia tani mbaj një pjesë të tij, dhuratë nga një grua shpirtbardhë, si një mrekulli që rilind në dhimbje e dashuri.

E unë qava atë ditë, për ata njerëz të bukur, që pa fjalë sjellin jetë në rrugën time, që më kujtojnë sa e thellë është zemra jonë, sa e gjallë është trashëgimia që kemi, e sa e pafund dashuria që s'vdes kurrë.

Kështu, çdo copë e këtyre veshjeve, e këtyre kujtimeve, mbetet si një puthje e lehtë mbi plagët e së shkuarës, dhe më çon më afër ëndrrës për të ruajtur këtë thesar,

për t'i treguar botës të fshehtat që mbartim, histori që flasin nga zemra në zemër, nga brezi në brez.

KURORA E VJETËR

Nga duart e një gruaje të munduar,
Mora veshjen e parë, një thesar i dhimbshëm.
Ajo s'ma shiti veç për nevojë,
Por për një hall që shponte zemrën.
Një nderim i heshtur mes nesh u ngrit,
Unë i zgjata dorën me ndihmë,
Ajo më la pas një copë historie,
Që fsheh kujtime, shpresë, dhimbje, krenari.
Kështu filloi udhëtimi im për traditën,
Një veshje e mbushur me lot dhe mall.
E tani, si kurorë mbi kohën që ikën,
Vijoj të mbaj të gjallë ato pëlhura të shtrenjta.

NË RRUGËN E KUJTIMEVE

Nën ritmet e dikurshme,
Që ngjiten si puhiza në frymën e rrugës,
Kënduam sot, bashkë si dikur,
Në krahët e nostalgjisë, në krahët e të tashmes.

Në pasqyrën e makinës, fytyra të qeshura,
Dritat e vjetra vezullojnë,
Ëndrrat që shkuan e ëndrrat që rrinë,
Duke u ndërruar mes asaj që ishim
Dhe asaj që sot jemi bërë.

Në dorë përqaftime të harruara, në zemër
Një gëzim i thjeshtë, i përjetshëm,
Bashkë në këtë rrugë, të çliruar e të qetë,
Si fëmijët tanë në këngët e familjes sonë.

SEKRETI QË DIGJET PA ZË

Asgjë nuk tha.

Sy që flasin një gjuhë që nuk njihet,
Mbushur me hije, me kujtime të ngrira.
Një ditë e errët, e fortë, e shkelur në kujtesë,
Kur ata u larguan nën hijen e dhimbjes.

Ajo mbeti, një heshtje e mbyllur,
një fëmijë që u bë gur.
Flet me sytë, jo me fjalët.
Në shikimin e saj rri diçka më e rëndë se lotët.

Nuk e ndan, nuk e tregon, por është aty,
si një plagë që jeton brenda lëkurës.
Dhe unë e di,
Se përtej asaj qetësie
Fshihet një botë e rrëzuar,
Një sekret që digjet, pa zë,
Në heshtje që askush s'mund ta kuptojë.

NË SYTË E SAJ

Ajo nuk foli kurrë, as atë ditë, as sot,
Në heshtje mbajti brenda një botë të thyer,
Sytë e saj flisnin me gjuhën e plagës,
me peshën e asaj që nuk mund të thuhet.

Një ditë e vetme – një natë që s’u shua kurrë,
Kur bota e saj u bë copë para syve,
Baba dhe vëllau u larguan në heshtje,
Dhe ajo mbeti – një fëmijë në terrin e vet.

Si një lule e shkelur, ajo u rrit pa zë,
Duke u mbështjellë me hije për të mos u parë.
Në qetësinë e saj kishte një oqean dhimbjeje,
Një barrë që askush s’mund ta njohë.

Unë e pashë në sytë e saj atë sekret të rëndë,
Atë thirrje që s’doli kurrë prej buzëve të saj.
Por në shikimin e saj, në heshtjen e qetë,
Ndjeva një shpirt që mbijeton pavarësisht gjithçkaje.

GRUA E LIRË E FORTË

Ata ikën në natën pa kthim,
Zhdukur në hijet e luftës, të zhurmës.
Mbetë ti, me zemrën copë e me duart bosh,
Një nuse e re, e bërë grua e vetes dhe e botës.

Në heshtje ndërtove një kështjellë pa mure,
Një strehë për fëmijët që ti u bërë nënë e baba,
Ndërsa çdo ditë sfidoje varfërinë si një luftëtare,
Dhe çdo fjalë që të godiste, e ktheje në forcë.

Ashtu e re, mes sfidave dhe netëve pa gjumë,
Me duart që shtronin bukë dhe zemrën në zjarr.
Ti u rrite, u rrite më shumë se toka dhe qielli,
Se çdo gjë që të zinte frymën, të jepte krahë.

Nuk kërkoje asgjë, veçse një botë për fëmijët e tu,
Dhe dritën që burrat e tu s'patën fat ta shihnin.
Ti je hija që mbetet, ajo që askush s'e shuan,
Grua e pathyer, që bën jetë me shpirtin tënd të gjallë.

ZËRAT E PAÇLIRUAR

Të heshtura si rrjedha e lumit në errësirë,
Ato gra u mbërthyen në heshtjen e dhimbjes,
Në plagët e fshehta që asnjë gjykatë s'i pa,
Në britmat që u tretën në dhoma pa dritë.

Gjithë ëndrrat e thyera si copa qelqi,
Janë gjurmët e tyre në udhëtim të përjetshëm.
Kurrë s'u ndalën – as në lot, as në plagë,
Forca e shpirtit të tyre digjet në heshtje.

Kush i dëgjoji? Askush!
Kush u dha dritë? Asnjëherë!
Por ato janë këtu,
Si hija e një beteje që s'u ndal kurrë.

NË BINARET E JETËS

Ishte një kohë... e shkuar si një stinë e harruar,
Ku gjithçka ndalej në hije dhe drithërimë,
Por tani, diku mes thirrjes së diellit dhe hapat e mi,
Ndjej një zjarr të ri – i heshtur, i palëkundur.

Sytë m'i hap agimi i mundësive,
Një ritëm i vjetër që më rrokullis,
Si një melodi që s'e dëgjoj askund
Veçse në frymën time të ringjallur.

Jam kthyer, por jo e njëjtë.
Është forca ime që lëviz, si shiu që rrëshqet,
Pa pyetur për duar që ndalen.
Unë flas për gjërat që përjetoj vetë .

RIKTHIM NË DRITË

Udhëtova përmes erës, përmes furtunës,
Në rrugë të errëta, nën re të hutuara.
Por drita e shpirtit ndricon dhe mes zhurmës
Një shkëlqim i largët që më thërriste prapa.

Tani rruga e ndritur më pret me ngrohtësi,
Familja ime – zemra dhe fryma e gjithçkaje.
Kthehem në binarët ku koha gëlon,
Dhe zemra ritmon me pasion të ringjallur.

Në krahët e dashurisë, në gjurmët e paqes,
Jam më e fortë, e plotë, si kurrë më parë.
Me vullnet për punë, për ëndrra të mëdha,
Në çdo hap të jetës që po ndërmarr.

GRUAJA E MIRDITËS

Ajo ecën maleve, me shpirt të paepur,
Në gjak i vlon kryqi, qëndisur në shpinë,
Nën peshën e përjetësisë, sakrifica që s'shihet,
Në gjurmët e saj e çon flamurin, aty në ëndrrat pa djegur

Fustanella me hire mbulon trupin e saj,
Si qiell i natës me yje, qëndisur nga duart e stërgjyshëve,
Aty, mes fillit të hollë e të argjendtë,
Fiset linden dhe Kanuni zgjohet me çdo pëshpërimë.

Në çdo rrudhë të duarve të saj, një varg historie,
Në çdo fije që ka qëndisur, një betim për këtë tokë,
Asnjë pushtues s'ia ka thyer muret e kësaj lirie
Ashtu siç nuk thyhet shpirti i saj në britma krenarie .

Besa e saj është ligj i pashkruar në buzë,
Që me krenari bëlbëzoi në heshtje
Foli pa zë, pa fjalë të mëdha,
Por të gjithë e ndiejnë thellë, si zërin e dheut që gufon në
heshtje.

Gruaja e Mirditës, kështjellë mbi shkëmb,
Si yll në qiellin e natës, fanar që ndriçon
Në heshtje mban breza, një trashëgimi të lartë,
Që duar më duar krenari përshkon

Ajo qëndron krenare, një grua si askush,
Me shpinën e saj mbushur me histori e me besë,
Aty lindin dhe bien burrat dhe trimat,
Aty mbijeton e kalon koha, mbi gurët e dheut të saj të
dashur.

Brez pas brezi, zemra Arbëreshe
Kur vdiq Skënderbeu, kur ra shqipja përdhe,
Në shpirtrat tanë lindën rrënjë të thella,
Dhe morëm me vete fjalën e lashtë, bashk me fe.

Gjakun e lirë, këngët e gurta, flamurin me shqiponjen dy
krenare në shpirt.
Në breg të huaj u mbollëm si farë,
Në dhe të thartë e të largët si ëndrra,
Por nuk u tretëm, nuk u shkrimë bashkë me vesën si ar

Ne ishim Arbëreshë, rrënjë të një peme të lashtë.
Nga fjalët e nënës e këngët e gjyshit,
Lindën legjendat e tokës së lënë mbrapa,
Dhe në çdo valë, në çdo thurje të shamisë,
Ruajtëm një copëz të së dashurës Shqipërisë .

Në festa ngrihemi si shpendë mbi dhe,
Me veshjet e stolisura nga duar të bardha.
Në çdo ngjyrë një kujtim, në çdo fije një jetë,
Në çdo hap që hedhim, një varg i Skënderbeut.

Besën s'e thyem, doket s'i harruam,
Në kishat e heshtura i ndezëm qirinjtë.
Një kryq i gdhendur, një lutje që shpëton,
Na bashkon me paraardhësit, në qiellin e fshehtë.

Edhe gjuha, oh gjuha e lashtë e gjakut,
Që rrjedh si lumë ndër breza të shenjtë.

Nga goja e prindit te buza e fëmijës,
Jeton e shndrit si dritë në errësirë.

Me gjellët e zjarrita, me aromën e vendit,
Me shijen e djathit, me erën e bukës.
Në sofër ne ngremë dolli për të shkuarën,
Dhe kurrë nuk i lejojmë kujtimet të thahen.

Pesëqind vjet larg, pesëqind vjet largësi,
Por ne jemi Shqipëri, Shqipëri që s'plaket.
Në çdo zemër Arbëreshje, një mal, një det,
Një flamur i gjallë që s'bie kurrë poshtë.

Dhe kështu do mbetemi, brez pas brezi,
Në tokë të huaj, por me zemër të kthjellët.
Arbëreshë, me gjuhë, me këngë, me zakone,
Pasardhës të shqipes, kujtim i pavdekshëm.

PUTHJE E HUMBUR

Ishte veç një puthje, një çast në amshim,
Një fllad që preku thellë zemrën e heshtur.
Dhe u tret si mjegull, si gjurmë në rërë,
Por mbeti aty, ku shpirti im e pret.

Sa herë që mbyll sytë, ai çast zgjohet prapë,
Si një yll që nuk shuhet në qiellin tim.
Një dashuri që s'pyeti për fundin, për ndarjen,
Por mbeti në heshtje, si këngë pa zë.

Jeton në kujtesë, në zemrën që rrëmon,
Një puthje e humbur, një fjalë që s'u tha.
Në rrjedhën e kohës, një shpirt që s'u tret,
E ngrohtë në mua, si një yll që s'ka rënë kurrë.

VRAPI I HIJES

Në errësirën ku drithëron qetësia,
Ku hapat e tu shkojnë pa kthim.
Një hije rrëshqet si erë e ftohtë,
Një vështrim i zbrazët, një frymë pa zë.

Në pyllin që heshtjen e ruan si thesare,
Gjithçka të thërret të vraposh më shpejt.
Por ndjen që sytë e padukshëm të ndjekin,
Si një fantazmë e hijëzuar që s'dashuron dritë.

Dhe ti vrapon, ndjen gjakun të nxehtë,
Në çdo hap që shkel mbi gjethet e vdekura,
Në labirintin e frikës, një ëndërr e vrazhdë,
Ku veten s'e njeh dhe hijet të presin përbri.

Mund të ndiesh, gjithsesi, si je gjallë,
Në çdo frikë që të mban të lidhur për natën,
Në çdo hap që të afron me të padukshmen,
Ti vrapon, ndoshta për të mbetur pa u tretur.

BIJA E ILIRISË

Në hijen e maleve të vjetra si legjenda,
Ku tokës i flet gjaku i të parëve tanë,
Unë jam bijë e Ilirisë, me flamur të gdhendur,
Në petkat e lashta që kujtojnë përjetësinë.

Në xhubletën time frymë gjej e zjarr,
Si mburojë prej motesh, ndër gishtërinj të lidhur.
Ku çdo fije qëndis shpirtin e shenjtë,
Tingëllon si këngë nga zanat që na ruajnë.

Më thërret zëri i Dodonës në erën e thellë,
Në dhe të plakur ku Apolloni flet në heshtje.
Ku vargjet janë kala e rrënjët janë fjalë,
Dhe çdo hap është një rit i lashtë, pa kthim.

Jam bijë e shqipes me flatra prej zjarri,
Ku miti dhe toka në një trup janë bërë.
Në çdo dorë që prek atë që mbaj mbi supe,
Unë bëhem legjendë, bëhem rrënjë, bëhem zë.

ODISE E RE

Jam bijë e erërave që nga lashtësitë,
Me gjak mitesh në damaret e kohës.
Heshtur flas me nimfa të maleve,
I kërkoj hijen Prometeut nën yjet e natës.

E djeg e rithemeloj, çdo fije të humbur,
Nga fustanellat që ndajnë tokën nga qielli,
Mbledh hirin e Orfeut, mësoj të këndoj,
Një himn që s'ka frikë të sfidojë perënditë.

Në çdo penjë që qëndis, përziej Odise,
Një udhëtim të pashterur, në rrokullimë shpirti.
Ku Hyjneshat janë gra të zakonshme,
Dhe legjendat thuren në pëlhura të gjalla.

Në këtë tokë të lashtë si vaji i lisave,
Ku dhe gurët kujtojnë vargjet e stërlasshta.
Vesh të shkuarën si fustan i thurur me flakë,
Dhe jam Odise që shpirtin s'e lë mbrapa.

NOSTALGJIA

Në gërshet të lashtë e të ri, mëndafshit fjalë,
E mbledh copëzat e shpirtit të harruar,
Me duar që njohin rrënjët, dantellat e gurta,
U jep jetë pëlhurave që s'plaken kurrë.
Etnologe e zemrës, hulumtuesja ime,

Nderon të kaluarën si flakë që ndriçon,
Në çdo rrobë, në çdo qepje, një kujtim fle.
Një xhublet që flet si thëllëza e malit.
Në diplomaci të fjalës, butësinë mbjell,
Në mes të kulturave, ura ndërton,
Me heshtje e me zë, për liri këndon,
Në botë që ndryshon, me rrënjë që s'harrohen.

NË GJURMËT E SUKSESIT

Urrejtja juaj është si një hije e kotë,
Një re e zezë në qiellin tim të ndritshëm,
Se sukcesi im ndriçon vetvetiu,
Përtej çdo përpjekjeje për të më ndalur rrugën.

Kush do të ma ngarkojë barrën e borgjit,
E di që në shpirt e ndjen peshën e humbjes.
Por unë qëndroj, me hapa të lehtë,
Përmes stuhive që s'munden të më lëkundin.

Sa herë që më shtyjnë drejt greminës,
Gjej forcë për të ngjitur lartësi më të reja.
Në heshtje, pa fjalë, në punë që ndrit,
Unë jam fryma që s'kapet në rrjetat e errëta.

Kushdo që më sheh me sy të zi,
Le të kuptojë se unë s'jetoj për zemrën e tyre.
Veç për të ndjekur dritën që në shpirt kam,
Pa i mbetur borxh askujt, as pa u ndalur

E FORTA QË HESHT

Një grua e heshtur në stuhi qëndron,
Me duar që krijojnë, me shpirt që duron.
Ajo s'kërkon asgjë, veç të shërbejë,
Edhe kur fjalët thika janë që s'të lënë të kthesh.

Me buzëqeshje të lehtë fsheh çdo brengë,
Zemrën e saj s'e lëshon në skaj.
Në çdo pengesë, një shkëmb qëndron,
Si një rrënjë e thellë që as era s'e shkul dot.

Të tjerët ndoshta nuk e shohin forcën e saj,
Sepse ajo nuk tregon kurrë plagën me zë të lartë.
Por një ditë, kur koha të flasë vetë,
Do kuptojnë sa shumë peshë mban shpirti i saj i heshtur.

Kjo grua nuk kërkon të shihet si hero,
Ajo vazhdon rrugën me nder dhe pa zhurmë.
E lirë në qëllimet e saj, pa e humbur kurrë vetveten,
Në heshtje ndërton urat që të tjerët i shembin.

GRUA E QËNDRUESHME

Në shtëpi hyre me zemrën e bardhë,
Punove pa fjalë, pa zë të lartë,
Respekt dhe nder i dhe çdonjërit,
Edhe pse shpesh të panë padrejtësi.

Ata të ngjyen në prapaskena,
Të morën fjalë, dhe të hoqën ngjyrë.
Por ti qëndrove, si shkëmb në mes dallgësh
Me kokën lart, duke përballuar çdo furtunë.

Kurrë nuk ankove për dhimbjen e shpirtit,
Qëndrove krenare, e fortë si muri,
S'pranon t'u lëshosh vlerat e tua,
Edhe kur të tjerët të shihnin si humbje.

Grua e mençur, që flet me veprime,
Zemra jote të rreh me nder e qëllime.
Ata mund të të marrin pasurinë e jashtme,
Por kurrë s'do të thyejnë shpirtin që ke brenda.

Qëndro moj grua, lartësinë mbaj,
Sepse forca jote nuk lëkundet nga fjalë.
Një ditë do kuptojnë vlerën tënde,
Ti je drita, që s'ndalet në natën e errët.

GRUAJA SHQIPTARE NË VEK

Gruaja shqiptare, në tregun e vjetër,
Me duar të njomura, mbushur me punë,
Qep e thur, ndan buzëqeshje,
është shpirti tjetër

Me shaminë në kokë, dhe dorën pa ndalur ,
Gërsheton ngjyrat me plot frymëzim
Ajo nuk është vetëm tregtare,
Ajo është historia me ngjyra ngjallur .

Një copë pëlhure, një thurje, një pjatë,
Aty për familjen për lumturinë
Aty në vek me ngjyrat lufton si me shpatë
Të ruajë shpresën, të ruajë dashurinë.

Dhe ndonëse varfëria ka goditur shpesh,
Ajo asnjëherë nuk e ndal punën.
Si nënë, si grua, pa rënë kurrë ndesh
Nuk kërkon lavdërim, s'e pranon humbjen .

Gruaja shqiptare, rrit në sakrifica
Thur me duar malli aty në vek
Shpirtin e një kombi, rritur nëpër ngrica
I qeshet fytyra në çdo copë që shet .

Për gruan shqiptare, adhurim cdo punë ,
Me duar të arta pleks gjithë dashuri.
Në çdo qepje, në çdo hap,që hedh,
Mbush plot me buzëqeshje dhe krenar.

TRËNDAFILI

Në agimin e ditës, në puhizën e qetë,
Çel trëndafili, me zjarr në gjeth.
I kuq si zemra që rreh pa pushim,
Si dashuri e thellë, e fshehur nën thinjë.

Fletët e tij janë flakë e jetë,
Pasion që digjet, por kurrë nuk tret,
Qëndron krenar mes erës e shiut,
Lule e shenjtë, roje e dashurisë së dliirët .

Trëndafil i kuq, dëshmitar i heshtur,
I ndjenjave tona që s'janë shterur.
Një çast bukurie, një prekje qiellore,
Në kopshtin e ëndrrave tona njerëzore.

Në aromën tënde gjej shpresë e ngushëllim,
Dhe në ngjyrën tënde një premtim pa mbarim,
Se dashuria s'vdes, sado të provojë,
Ajo vec çel sërish, di veç të dashurojë .

NËNAT E SHQIPES

Nënat shqiptare, punëtorë të heshtura,
Në duar mbajnë fije jete gjithë dashuri .
Aty tek kokë e tyre ,i zbardh dita ,
Përherë me mendimin për ata fëmijë .

Të lodhura, me fytyrën gjithë mirësi ,
Për bukën e gojës, punojnë deri vonë,
Në krahët e tyre, gërshetohet historia,
Që fëmijët e tyre jetën të gëzojnë .

Veshmbathje, që ngjallin kujtime,
Të punuara me mund dhe dashuri,
Edhe në varfëri, ato s'ndalën,
Të mirat fëmijëve të saj tu falen.

Në çdo copë pëlhure, ruhet një kujtim,
Një simbol kulture që kalon brez pas brezi,
Me duar të lodhura, mbajnë gjurmët e shkuara,
Që fëmijës së tyre ti qeshë fytyra.

Edhe unë pas nënave, e mbaj këtë thesar,
Ruaj ato veshmbathje, ato simbole,
Për të mos harruar se kush jemi ndër vite,
Për të mbajtur gjallë atë shpirtin e një tradite.

SHALLI I RUGOVËS

Shalli i Rugovës, mbështjellë me nder,
nën plisin e bardhë, që ngrihet si një mal i shenjtë.
Një copëz historie që valvitet motesh
Betim burrërie për njeriun me vlerë .

Ata janë të njohur, burrat e fjalës së vërtetë,
me moralin që nuk thyhet, e me besë të paprekur.
Në secilin fije, një betim që nuk tretet ,
një lidhje që kalon shekujt dhe nuk fshehet.

Në krahët e tyre, shalli është si një flamur,
në çdo fjalë të thënë, qëndron e drejta dhe guximi.
Ata që e mbajnë, e mbajnë me krenari,
për shenjtërinë e asaj që u është besuar.

Shalli i Rugovës, shenjë e moralit të lartë,
që e ngre lart nderin, po ashtu si plisi
në çdo hap që bëjnë, një histori rinisi,
një testament me zë të lartë burrërie.

Në çdo veshje, secili ruan një histori të paçmuar,
për Rugovën, për shqiptarët, për traditën e paprekur.
Një simbol që flet për besë, për moral dhe nder,
dhe që do të jetojë përherë, si një vlerë që s'ka vdekur.

XHUBLETA, LIDHJA E GJENERATAVE

Xhubleta, një simbol që nuk vdes, 4000 vjet histori që enden në çdo fije. Një histori që na bën ne shqiptarët krenar .

Si një piramidë, qëndron mbi trup, një vallëzim i traditës, që nuk shuhen asnjëherë. Aty në kujtimet tona mbetet gjithmonë .

Dhe ja, një tjetër ditë, në duar të sotme, ajo përsëri merr formë. Nga thellësitë e shekujve xhubleta ngrihet krenare dhe madhështore parakalon në sfilatat e kohës e ruajtur dhe e shpallur vlerë e lartë trashëgimie .

E thurur, e mbushur me argjend, po njësoj, dhe asnjëherë më pak e fuqishme.

Ajo ka mbijetuar, ka kaluar çdo rreth, nga brezi në brez, si një forcë që kurrë nuk mposhtet.

Si një mal i paepur, mbështetur mbi natyrën, mbështjellur në dhimbje dhe krenari, ajo është gjithmonë e sotme, gjithmonë e tashmja.

Në çdo hap që bëj, ajo është prapa meje, një kujtim i pandalshëm, një lidhje e gjallë.

Po e mbaj, po e respektoj, si një pjesë e imja që më bën të ndihem krenar,

po ashtu si ata që e bënë, para meje.

Xhubleta, më shumë se thjesht një veshje, është një shpirt që jeton në secilin nga ne.

Asnjëherë nuk është thjesht e kaluar, ajo është gjithmonë e pranishme, çdo herë, kudo, si një simbol që nuk do të humbasë asnjëherë.

MBI PLUHURIN E HISTORISË

Në ditët pas luftës, mes dhembjes dhe shpresës,fillova të mbledh gjurmë të lashta të shqiptarisë.Veshjet qëndisur, në cepa të harruar,copëza identiteti, në botë të shpërndarë.

Çdo rrobë që gjeja, mbante dhimbjen e kohës,si plagët e një toke që u bë shkumb e hi.

Kërkoja nëpër fshatra, nëpër duar të thjeshta,veshje të humbura në rrjedhën e shekujve të trishtuar.Mbi 250 veshje i mbledha në heshtje,me shpirtin e lodhur, por plot me krenari,

dhe çdo copë që ruaj, është një muze pa mure,një trashëgimi që shpirti kurrë s’e lë të humbë.

Ende ëndërroj një muze të madh,ku të frymojë çdo rrobë e lashtë,por s’ka mundësi—për këtë thesar të çmuar,që më mban gjallë, edhe pse kaq shumë jam vvarë.

Gjithë dhimbjen time e kam fshehur nën buzëqeshje,por çdo fije që mbaj, është sakrifica ime.

Mbi pluhurin e historisë që s’do harroj,një trashëgimi që shpirtin s’e ndaloj.

UNË, RUAJTËSE E TRASHËGIMISË

Tash e 25 vjet mbledh histori të gjalla, veshje kombëtare që flasin pa fjalë.

Në secilën fije, një rrënjë shqiptarie, në secilin ornament, një ëndërr lirie.

Nga malet në fusha, nga lindja në perëndim, mbledh copa identiteti, të lashta e plot shpirtim.

Parada në natyrë, në vende larg e afër, me krahë të hapura e shpirt të hapur.

Libri im një kapitull, por jo fundi i rrugës, edhe pse u paragjykova, vazhdoj pa gjurmë dyshues.

Disa më injoruan, disa më deshën, por asnjëherë s'ma ndalën hovin, që kaq fort më rrënjos brenda.

Ata që më kopjuan, në hije mbeten, se origjinali shndrin, kurrë nuk tretet.

Unë jam e para, ruajtëse dhe flakë, revolucioni i traditës, zë që s'ka të ndalë.

Në secilën pjesë që mbledh, unë gjej veten, shpirtin tim të pashuar, që kurrë s'humbet në rreth.

Unë jam trashëgimia, e gjallë, që ecën, dhe historia ime, në veshje, përjetë.

PLISI I BARDHË

Derisa plisi në Dukagjin qëndron,
i bardhë si bora, mbi ballë i vendosur,
fisnikëri e burrëri ai flet,
me historinë e tij kurrë i lodhur.

Një mburojë e qetë e shpirtrave të lashtë,
një dritë e pastër mbi krye që shndrin,
me plis në kokë, betohet shqiptari,
si malet e larta, nderi s'i shterin.

Çdo rrudhë mbi plis, një histori thur,
një rrëfim i gjatë prej gjyshërve tanë.
Ndër fusha e male ai shtegton,
si dëshmi e besës që kurrë s'u ndanë.

Oh, plis i bardhë, krenari e vjetër,
simbol i dëlirësisë dhe i fuqisë,
me ty mbi krye, ne jemi një,
bijtë e asaj toke, që kurrë s'u thye.

DIELL PËR TË TJERËT

Unë jam plot diell nga jashtë,
brenda, sfida më sundojnë,
beteja të heshtura, që kurrë s'i imagjinova,
por për ta, veç dritë reflektoj.

Ditë për ditë, unë jam diell,
askush s'pyet ç'ka prapa kësaj drite.
Mendojnë se jam e pasur, e lumtur pa masë,
si dhurata më vijnë gjërat, lehtë e pa kujdes.

Por asnjë nuk sheh retë që mbaj brenda,
shirat që fsheh me buzëqeshje.
Në çdo dritë që shpërndaj për botën,
mbaj fshehur dhimbjet e mia të qeta.

UNË JAM

Unë jam shoqja që isha dje,
ajo që pa fjalë krahët të dha,
ajo që motër të thirri me zë,
kur në shpirt stuhitë t'u ngritën pa fre.

Unë jam ajo që rrugën ta ndriçoi,
në errësirë kur humbe të qetën,
ajo që gjithçka, pa kushte ta dhuroi,
e ti për kë t'i shtrive hapat t'u tretën?

Unë jam ajo që mburojë të dha,
kur frika të rrethoi e shpata u ngrit,
ajo që kur rrëzoheshe, dorën ta shtriu,
dhe për besë, për ty flijimin e priti.

Por tani, kur prapa kthej sytë,
në shpirt vetëm hije shoh e një gënjeshtër,
ti ike e premtimet t'i hodhe në hi,
tradhtia jote, plagë e pafjalë, e thënë veç në heshtje .

TY DASHNI QE TE KAM LARG

Kur je larg, por zemra jote më ndjen,
distanca humbet, vetëm një hap na ndan.
Në çdo frymëmarrje të dua më shumë,
siç dallgët kërkojnë bregun në agim.

Ditët kalojnë, të kërkoj në çdo fjalë,
sikur zëri yt të më thërrasë ngadalë.
Largësia s'do të mund të na ndalojë,
dashuria jonë, si flakë, kurrë s'do të shterojë.

Kur je larg, por zemra jote më ndjen,
distanca humbet, vetëm një hap na ndan.
Në çdo frymëmarrje të dua më shumë,
siç dallgët kërkojnë bregun në agim.

Shkruaj letra, kujtime nga netët që patëm,
e ruaj të gjitha, të ngrohta, në shpirtin që s'e ngratë.
Gjithçka që duam është vetëm një ëndërr larg,
do vij prapë tek ti, sikur hëna në natën e bardhë.

Kur je larg, por zemra jote më ndjen,
distanca humbet, vetëm një hap na ndan.
Në çdo frymëmarrje të dua më shumë,
siç dallgët kërkojnë bregun në agim.

Në çdo yll të natës, unë ty të shoh,
malli më mban të fortë, nuk dorëzohem jo.
Një ditë do vij, kur të gjithë ëndrrat t'i prek,
dhe atëherë s'do ketë largësi që ne të na ndjek.

KËNGË E KTHYER NGA KOHA

Rashë një ditë si gjethe e rënë,
E ndjeva dhimbjen e kohës, të rëndë.
Një dallgë më rrokullisi, më flaku,
Por nuk u munda, s'u shkatërrova.

Këngë e vjetër më ngjitet pas,
Më prek kujtimet, ditët që lashë.
Sikur koha të kthehej, një çast,
Dhe t'ia dëgjoja ritmin përsëri.
U ngrita si shkëmb përballë stuhisë.

DRITAT E SYVE TË MI

I dua vitet, ato vite kur isha diell,
Kur çdo mëngjes zgjohesha me zërin tuaj,
Netët pa gjumë, kur këndoja për ju,
Ninulla dashurie për dy engjëj të vegjël.

Dritat e syve të mi, sa bukur ishin ato vite,
Kur ju rriteshit nën qiellin e shtëpisë sonë,
Sfidat i harroja, çdo lodhje bëhej e lehtë,
Se ju ishit fryma, ishit rrezja e dritës.

I kujtoj përqafimet , qeshjet tuaja,
Cdo hap që hidhnit, me lot dhe me gaz,
E tani jeni rritur, por në zemër, përherë
Ju mbeteni ata vogëlushë që dua pa masë.

E TRADHTUAR

E ndjej tradhtinë e vetvetes,
Sa herë që kujtimet më rikthejnë në gabimet e mia.
Kam qëndruar në heshtje, ndërsa fjalët luteshin për të
shpëtuar.

Netëve pa gjumë, kam ndërtuar kujtime.
Nga ëndrra që s'i pashë kurrë.
E ndjej tradhtinë e fatit,
Ai vërtitet rreth meje si një orbitë pa fund.

Nga dasma e prindërve, më ndjek me kujtime të
habitshme,
Si anije e përmbytur pas dallgëve të pashtershme të detit.
Sjell dashuri të avulluara mbi gjethet e vjeshtës.

Por më shumë ndihem tradhtuar nga njeriu,
Ai që nuk arrin të lindë agimet në sytë e tij.
Mbulon ditët me xhelozë dhe ngrin kujtimet,
Ngre monumente për arritje që i vret vetë,
Me thikën e zilisë.

Tradhtia ka emrin Rozafë,
Ajo mban gjallë një kështjellë të lashtë,
Si një premtim i heshtur, një këngë pa zë,
Një amanet që ne ngritëm për mungesën.

E mbështjellë nga heshtjet e sakrificës
Një jetë në krahët e sakrificës rrite,
Në varfëri, në përlulësi, pa u ndalë,
Linda e rrita nën hijen e përbuzjes,
Fjalët e hidhura që s'e dinin as falë.

Çdo ditë, gur më gur ndërtoja rrugën,
Për të sjellë dritë aty ku ishte terr,
Por familja, në vend që të ndihmonte,
Ma mori dhe ëndrrën, ma mori dhe zërin e brishtë.

Respektin e dhashë, në heshtje dhe në lot,
Por ata kthyen fjalë, gurë e shpata të mprehta,
Në çdo hap, në çdo ëndërr, më thyen,
Edhe kur dhimbja më mbyllte sytë e mprehta.

Më ndaluan në punë, më ndaluan në ëndërr,
Më morën karrierën, më morën dhe shtëpinë,
Por unë qëndroja, qëndroja si një mal i heshtur,
Nga brenda zjarr, nga jashtë borë dhe pluhurin e thinjë.

Kjo jetë më ndau, më plagosi thellë,
Por shpirti im s'u përkul, s'u dorëzua,
Në çdo sakrificë gjeta forcën time,
Edhe në natën më të errët, unë vazhdova.

HIJA E DREJTËSISË

Në rrugët e qytetit, erdhën si furtunë,
Mëkatet e tyre, një hije mbi zemrën time,
Policia e dhunshme, një thikë në shpirt,
Na morën nga duar, shpresën e mbështjellë me dhimbje.

I vogël ishe, kur ndihesha si mbrojtës,
Të rritja me dashuri, në çdo hap të jetës,
Por pas një sërë ngjarjesh, dhimbja na ndau,
Kur policët erdhën, për të marrë atë që ishte jona.

Vëllai im, një dritë në errësirën tonë,
Tani një kujtim, në një botë që nuk është e drejtë,
u rritëm së bashku, me ëndrrat në zemër,
Por ata erdhën, dhe morën çdo shpresë.

Çdo ditë që kalon, kujtimi është një plagë,
Kjo jetë e vështirë, me dhunë të mbuluar,
Por ne do të flasim, do t'i japim zë zërit,
Sepse çdo viktimë meriton një histori, një dritë.

Sot ngritemi lart, për ata që vuajtën,
Për çdo të ri që pa, në errësirë të mbetur,
Do të luftojmë për drejtësi, për çdo shpirt të lirë,
Për vëllain tim, për të gjithë, që s'duhet të harrohen.

FJALË TË HESHTURA

Në errësirën e natës, zërat ngjiten,
Vajzat , në kujtime rrinë,
Histori të hidhura, të mbetura të fshehura,
Në zemrat e tyre, një dhimbje e thellë rri.

Lufta mori gjithçka, edhe ëndrrat e bukura,
Në mes të frikës, u thyen të drejtat e tyre,
Por fuqia e brendshme, ndriçoi si një yll,
Pavarësisht çdo sfide , ato janë ende të gjalla.

Sekretet që mbajnë, si qelq në duar,
Një barrë e trishtë, një ngarkesë e rëndë,
Por në çdo lot, ndjejmë forcat e tyre,
Sepse ato janë luanë, që nuk e humbin dritën.

Nuk janë vetëm viktimat, janë heroina të heshtura,
Në çdo hap të jetës, qëndresa e tyre flet,
Për ata që vuajtën, për ata që mbijetuan,
Dhe për çdo vajzë që guxon të flasë sot.

Le të jemi zëri i tyre, le të thyejmë heshtjen,
Të ngremë lart emrat e tyre, të zbulojmë të vërtetën,
Sepse çdo histori duhet të dëgjohet, çdo dhimbje të
ndjehet,
Në dritën e drejtësisë, le të shkelin ato me krenari.

KUJTIME QË JETOJNË

Pas dhjetë vitesh, hapat e tua mungojnë,
Në çdo hap të jetës, ti je në mendimet e mia.
Prindërit e mi, me dashurinë e pafund,
Vëlla dhe motër , një lidhje që s'ndërpritet kurrë.

Në kujtimet e mia, zërat tuaj përsëriten,
Ngrohtësia e duarve tuaja, si dritë në errësirë,
Çdo ditë e kaluar, është një thesar i çmuar,
Në zemrën time, jeni aty, gjithmonë të pranishëm.

Ndarja ishte e vështirë, një dhimbje e thellë,
Por ju jeni yjet që ndriçoni natën time.
Më udhëhiqni në çdo hap, më jepni guxim,
Në çdo moment të heshtur, ju ndjej afër meje.

Do të vija t'ju nderoj, në vendin tuaj të qetë,
Dhe të flas me zemrën time, pa fjalë, me dashuri.
Kjo jetë është një rrugë, ndonjëherë e errët,
Por me ju në mendje, çdo hap bëhet më i lehtë.

Ndarja nuk është fundi, por një fillim i ri,
Ju jeni në çdo buzëqeshje, në çdo lot.
Në natyrën që më rrethon, në çdo fluturim,
E di se më shihni, dhe unë ju mbaj përherë në zemër.

PAS 10 VITESH ERDHE TI

Në fillim ishte hiri, një flakë e ndezur,
Pas ndarjes , mbetëm në errësirë, pa udhë,
Të ndarë nga njëri tjetri ,
Por dashuria jonë, si zjarri, nuk vdiq asnjë çast.

Tani kthehem tek ti, si era që sjell pranverë,
Në çdo hap të jetës, je ti, drita ime e mirë.
Dhimbjet e kaluara, si re që kalojnë,
Na bënë më të fortë, tani bashkë qëndrojmë.

Sytë e tu janë deti, në thellësi të thellë,
Çdo grimcë dashurie, është një thesar në këtë botë.
Çdo përqafim e çdo buzëqeshje, një shkëndijë,
Në krahët e tu, ndjej se s'kam frikë.

Ndarja na mësoi vlerën e çdo momenti,
Tani e di, ti je shpirti im, burimi i qetësisë.
Pas çdo stuhie, mbërrijmë në paqe,
Të dua më shumë se kurrë, më afër, më të fortë.

Kjo dashuri është si një kopsht, e mbjellë me kujdes,
Pas 10 viteve, ka lulëzuar, çdo petale është besim.
Së bashku do të ecim, paçim bekin ne çdo sfidë,
Sepse ti je burimi im, dashuria ime, përjetësisht e lidhur.

MOS HESHT

Mos hesht, oj shtyllë që qëndron mbi dhimbje,
Mos hesht, udhërrëfyesja e njohurive që ndriçojnë.
Mos hesht, ti perëndeshë që bukurinë trashëgon,
Ngri zërin, lartësoje si flamur mbi dallgët që të sfidojnë.

Numëro një e nga një heshtjet që t'i dhanë,
Sakrifica që të mbuluan, turp që të shtuan.
Qëndro si mal, mos u lëkund nga stuhitë e tyre,
Mos hesht, kur vetë janë thyer nga ndershmëria jote.

Mos hesht kur për intereset e tyre të përdorën,
Kur sulmet mizore të ranë pa mëshirë.
Kur si urë u bëre për të mbrojtur një nder,
Por prapë të lanë me plagë, pa kujdes, pa mbrojtje.

Mos hesht, se zemra jote s'duron më,
Mos hesht për lëndimet që nuk duken në sy.
Mos hesht për pështymën e tyre të pa cipë,
Ngrihu dhe flit për çdo peng, çdo plagë që s'të lë të flesh qetë.

Mos hesht kur punën me nder të ndaluan,
Kur njerëz të armatosur të frikësuan.
Kur pasurinë tënde, çdo pëllëmbë të grabitën,
Ngri zërin, mos lejo që heshtja të jetë fati yt.
Mos hesht, se brenda teje fryn era e një revolte,
Një shpirt që rri gjallë përtej plagëve të fshehta.
Mos hesht, se liria jote vlen më shumë se çdo frikë,
Mos hesht- se zëri yt është si një rrufe që ndez qiellin e natës.

SI MILINGONË

Tash, këtu jam, si një milingonë e vogël,
Që me durim ndërtimin e fillon përsëri.
Nga ajo që dikur shkëmb ishte, i pathyeshëm,
Një rezistencë e heshtur, e fshehur nën plagë.

Edhe milingonat jetojnë, dhe çdo ditë rriten,
Në çdo grusht dheu, një strehë e vogël ngrihet.
Secila fije e mbajtur fort nga duart e mia,
Një shpresë e vogël që rritet ngadalë në jetë.

Unë, që dikur rezistova si mal që nuk bie,
Tani ngrihem sërish si milingonë e qetë.
Me çdo grimcë që mbaj mbi shpinë, përparoj,
Ndërtoj një botë të re nga gërmadhat e së djeshmes.

Sepse edhe e vogël, jam një shpirt i pathyeshëm,
Çdo hap i imi është një fitore, një kujtim.
Se edhe në tokë, mes dheut të rëndë,
Unë mbetem e fortë, e gjallë – dhe përsëri lulëzoj.

HIJES QË KOPJON

Sa lehtë depërton mbi supet e mia,
Ti që nga larg imiton, pa u ndalur.
Menduar nga ty si diçka e thjeshtë, e lirë,
Të marrësh për vete atë që vetë kurrë s'e ke thurur.

Ti përdor miqtë e mi, si ura për të shkelur,
Përdor librin tim, një himn që kurrë nuk e shkruajte.
Duke menduar se fjalët që u thua janë të tuat,
Kur vetë e di se je veç një hije që më ndjek pas.

Në çdo fjalë që lë, në çdo varg që përkufizoj,
Ti merr për t'u dukur, për t'u zbukuruar.
Por e vërteta rri thellë në çdo rrokje timen,
E rrah, e thyen çdo hije që s'ka dritë për të duruar.

Sepse unë jam burimi dhe je ti që pi,
Një etje pa fund, që s'ngopet me të marrë hua.
Por, kujdes, se një ditë vetveten do ta harrosh,
Dhe në atë pasqyrë, hijen tënde do ta shohësh pa fjalë.

SHTËPIA E LARGËT

Kam lënë larg një shtëpi, një prag të dashur,
Plot kujtime, tinguj që në shpirt më përvëlojnë.
Dritare që dikur i hapja me duar plot ëndrra,
Oxhak që ngrohte netët e ftohta të jetës sime.

Aty janë muret që më dëgjuan të qesh, të qaj,
Çdo gur ka një copëz zemre që e lashë pas.
Një shenjë kujtese, një gjurmë malli të përjetshëm,
Si një hije që ndjek çdo hap të shpirtit tim.

Pragu i asaj shtëpie më thërret pa zë,
Si të donte të më kthente në kohën e humbur,
Dritaret presin sërish të shohin fytyrën time.
Oxhaku pret flakën që dikur ia dhashë me zjarr.

Kam lënë larg një shtëpi, por ajo s'më lë kurrë,
Në çdo vend që shkoj, me vete e mbaj atë prag.
Si një copëz e shenjtë, si një premtim që s'vdes,
Një shtëpi e largët, por gjithmonë pranë shpirtit tim.

Sa mall kam për një grusht dhe nga oborri im,
Ku rrita shtatin dhe mendjen, rrënjët e shpirtit tim,
Aty ku vera mbante sofrën nën hijen e mollës,
Rrethuar ne të shtatë, nën dritën e dashurisë së nënës.

Aty ishte jeta jonë, si një përrallë e lashtë,
Ku fjalët ishin të ëmbla dhe duart gjithmonë pranë.
Kur molla mbi kokë na qeshte si diell mbi ne,
E koha rridhte butë, si lum i qetë nëpër fshat.

Në sofër, buka na mbante bashkë në varg,
Çdo kafshore ndante kujtime që s'zduken kurrë.
Shtatë fëmijë që rriteshin me një ëndërr të ngrohtë,
Mes erës së dheut të bekuar, mes qetësisë së natës së
butë.

Sa mall për atë dhe që sot më duket aq larg,
Një copëz tokë që s'kthehet, por as s'më le të humbas.
Në çdo hap, e mbaj atë oborr në shpirt, si një ëndërr,
Një grusht dhe nga shtëpia ime — kujtim që s'venitet
kurrë.

BREGDETIT DHE PUTHJEVE TONA

Në bregdetin tonë, ku deti gurgullon butësisht,
Puthjet tona mbetën si gjurmë mbi rërë.
Fjalët që nuk thamë, si dallgë u tretën,
Ndërsa qielli na mbështolli në ngjyrë të përhimë.

Era e kripur flladin e puthjeve sillte,
Aromë deti dhe dashurie që nuk shteron.
Në çdo përqaftim si një dallgë që përplasët,
Kujtime që bregu i ruan pa zë.

Sa herë vjen deti me dallgët e tij,
Unë dëgjoj pëshpëritjet e të gjitha puthjeve tona.
Si këngë e fshehtë që e ndien vetëm bregu,
Një kujtim i përjetshëm nën dritën e hënës.

Tani, larg detit, me ty sërish endem,
Në mendje, në shpirt, në çdo thirrje zemre.
Puthjet tona ende atje valëviten,
Si det që nuk ndalon kurrë së dashuruari.

PREMTIM I HUMBUR

Më premtoi lumturinë e gjithë botës në duar,
Si qiellin plot yje që zbret mbi tokë.
Më dha vite dashuri që flakëronin si zjarr,
Por në fund, mbeta veç me heshtje dhe lotë.

Ishte premtim i ëmbël, ishte ëndërr e ndritshme,
Një rrugë e gjatë që mendova se kurrë s'do përfundonte.
Por diçka ndodhi, diçka u thye pa zhurmë,
Dhe as vetë nuk di se si erdhëm në këtë humnere.

Mora nga ai çaste plot ngrohtësi e dritë,
Dhe besova se dashuria ishte e pafund.
Por premtimet janë shpesh vetëm fjalë në erë,
Si dallgë që vjen e shkon, duke lënë boshllëk dhe
hidhërim.

Tani ec, me kujtime që peshkojnë në shpirt,
Me vitet që shkuan si ëndrrat që shuhen.
Ai më premtoi botën, por botën s'e gjeti,
Unë mbeta me një zemër që endet në paqe e plagë.

ZANAT E LUMIT

Në breg të lumit, nën dritën e hënës argjend,
Zanat shqiptare si hijeshi dalin nga ujërat e kthjellëta.
Me fustane të bardha që shkëlqejnë si drita e agimit,
Vallëzojnë në heshtje, të lira, të lashta, si vetë përrallat.

Këmbët e tyre prekin tokën lehtas si era,
Dhe lumi merr në vete çdo tingull të butë.
Flokët u fëshfërijnë si degët e vjeshtës së vonë,
Një koreografi qiellore mbi bregun e shenjtë të natës.

Kush i sheh, mbetet në ëndërr të përjetshme,
Kush i dëgjon, zëri i tyre si fllad e mbërthen.
Ato janë zanat e malit dhe të pyllit të egër,
Mbrojtëse të fshehta të tokës e të ujit që buron.

Në fustane të bardha, mbi bregun e lumit vallëzojnë,
Me hapa që shkelin butësisht mbi shekuj kujtimesh.
Si të kishin ardhur nga vetë shpirti i natyrës,
Në natën e heshtur, në përjetësi të bukur e të lirë.

AMANETI I TOKËS SË SHENJTË

Në brigjet e kësaj toke të lashtë,
Ku rrahin furtuna dhe fryjnë erëra,
U mboll besimi si farë e shenjtë,
Dhe mbin në zemrat që kurrë s'u tretën.

Këtu, mbi rrënjët e stërgjyshërve tanë,
Një xhubletë valon si flamur i shenjtë,
Mbi tokë e qiell, mbi male e fusha,
Përjeton amanetin që populli s'e harron.

Nga duart e grave që tjerrin fijen,
Nga endjet e burrave që punojnë tokën,
Çdo vegël që rreh, çdo dorë që ngre,
Ka skalitur me mund këtë tokë të shenjtë.

Çiftelia e lahuta, zëri i maleve,
Mbi degët e ahut i fryjnë këngët e lashta.
Një zë kumbues që s'ndalet kurrë,
I thotë tokës “Unë jam biri yt besnik.”

Kur n'gur e drurë, zanat shpatullën vënë,
Me sqepar e çekan ngulin çdo shenjë.
Dhe brenda zhurmës së zejtarëve tanë,
Lindin muret që fort përballojnë furtuna.

Në çdo fije, në çdo ngjyrë dhe punim,
Është historia e grave me shpirt të forte.

Që përkulen para Zotit, por kurrë s'thyhen,
Si gjethe të shenjta që flasin me qiellin.

Me gjunjë në tokë, duke shkukur barin,
Gra që e mbajnë shpirtin të pathyer.
Lutjet e tyre përkulin kohërat,
Dhe burrat, gur e zjarr qëndrojnë me besim.

Në mes të netëve kur dielli largohet,
Një dritë e vogël nga oxhaqet ndizet.
Shpresa e shqiptarëve nuk shuhet kurrë,
Dhe lutjet e nënës nga era përhapen.

Si mur qëndrojnë në mes të furtunës,
Besa dhe shpresa që kurrë s'thyhen.
Në sytë e çdo fëmije, në çdo buzëqeshje,
Në zemrat që flasin për dashuri e besim.

Dhe veglat e punës, veku dhe mulliri
Si kujtim që ndrit ndër shekuj e erëra.
Në duart e këtij populli kurrë s'veniten,
Dëshmitarë të heshtur të forcës së tij.

UNË JAM

Unë jam shoqja që isha dje,
Ajo që pa fjalë krahët të dha,
Ajo që motër të thirri me zë,
Kur në shpirt stuhitë t'u ngritën pa fre.

Unë jam ajo që rrugën ta ndriçoi,
Në errësirë kur humbe të qetën,
Ajo që gjithçka, pa kushte ta dhuroi,
E ti për kë t'i shtrive hapat t'u tretën?

Unë jam ajo që mburojë të dha,
Kur frika të rrethoi e shpata u ngrit,
Ajo që kur rrëzoheshe, dorën ta shtriu,
Dhe për besë, për ty fljimin e priti.

Por tani, kur prapa kthej sytë,
Në shpirt vetëm hije shoh e një gënjeshtër,
Ti ike e premtimet t'i hodhe në hi,
Tradhtia jote, plagë e pafjalë, e thënë veç në heshtje.

Në heshtje ndërtoj kalatë e mija
Më shikoni, në hije qëndroni,
Tek unë kalojnë, dhe prapë kalojnë,
Me syrin e ftohtë, të mbyllur, të rëndë,
Për atë që s'duan, për atë që s'ndjen.

Po unë, si guri në rrjedhën e lumit,
Ngulitur qëndroj, mes zjarrit dhe shkumbit.

Në heshtje ndërtoj kalatë e mija,
Me dorën e ashpër, me zemër te flori.

E di, nuk do ndaloj, sado të më injoroni,
Historia ime në rrënjë jeton, qëndroni!
Në çdo qëndismë, në çdo xhubletë,
Jeta qëndron, si fjala në letër.

Për ju jam heshtje, për veten jam zë,
E lirë në shpirt, qëndroj mbi dhe.
Mos u lodhni të më ndaloni në rrugë,
Se unë jam e kaltra, e ngulitur në gurë.

Shikoj në pasqyrë veten time
Në heshtje qëndroj, e thellë në vetvete,
Si drite e zjarrtë që s'fiket kurrë,
Tani e shoh atë që dikur s'e vlerësova,
Një shpirt të fortë, një shpirt të dliur.

Dikur, si lule në erën e jetës,
U fala si vesë për tokën e tjerë,
Duke harruar vetveten në krahët e humbjes,
Për vlera të rreme, për ëndrra të shtrëmbëra.

Po tani më shikoj në pasqyrën e qartë,
Sy që shndritin me forcë të vjetër,
E di, jam më shumë se ç'dhashë dhe mora,
Një mal i qetë, një det i thellë.

E dua veten time tani që e njoh,
Se kam duruar, se kam dashuruar,
E dua këtë shpirt që kohët kanë shëruar,
Si një perlë që ndriçon prej plagëve të saj.

BUZËQESHJA E HËNËS

Në qetësinë e natës, ajo vjen si hije,
Një dritë e butë, e bardhë si puhizë.
Përtej dritares më buzëqesh ngadalë,
Si shoqe e heshtur në ëndrra më shpall.

Oh, Hënë e ëmbël, aq larg, aq afër,
Me dritën e saj m'i prek ëndrrat e gjata,
Sa herë që syçelur mbetem e shoh,
Ajo më buzëqesh dhe flak gjumin ngado.

Në heshtjen e saj, më flet në çdo natë,
Më sjell qetësinë, e ngrohtë, e gjatë,
Më shtrin një rrugë prej argjendi në qiell,
Si për të më thënë se jam nën diell.

Kështu fle e qetë, me hënë pranë,
Ajo qëndron, deri sa unë zgjohem në agim,
Një buzëqeshje lë pas në dritare të mban,
Si një kujtim nga një natë plot me ëndrra

KAFE ME DIELLIN

Kur agimi më troket me dritë të artë,
Nga gjumi më zgjon si një mik i largët.
E unë, me filxhanin në dorë, rri pranë,
tek shoh si ngjitet Dielli ngadalë mbi anë.

Ai lind me ngrohtësi, më prek fytyrën,
Një prekje e ngrohtë, që ngrihet përpjetë.
Me rrezet që derdhen, të kthjellëta, të reja,
E unë përshëndes, si një mike pa fjalë.

Kafen e parë e ndajmë të dy,
Dielli më buzëqesh nga qielli kaltër.
Më ngroh në zemër, më jep energji,
Në këtë çast magjik, më bën të ndjej.

Kur ai rritet e ngjitet mbi mal,
E gjithë bota zgjohet nën puthjen e tij.
Unë rri e qetë, me kafen që mbaroj,
Nën një qiell të artë që më përqafton.

GRINDJE DHE DASHURI

Ne grindemi, si dallgët në det,
Me fjalë që shpesh bëjnë stuhinë.
Po zemrat tona, përtej reve
Njohin qetësinë që ndjen dashurinë.

Një fjalë e ashpër, një shikim i largët,
Por mjafton një prekje një dorë në dorë.
E kuptojmë sërish se kemi një zjarr të përbashkët,
Që s'e fik dot grindja, sado e fortë.

Dashuria jonë s'është e lehtë,
Është një lojë stuhish e qetësisht të thella.
Por sytë që kërkojnë njëri-tjetrin përsëri,
Janë dëshmi se ndjenja nuk shuhet nga fjala.

Unë dhe ti jemi dy flakë në një zjarr,
Që ndizen, përplasen, por kurrë s'shpërndahen.
Se dashuria jonë është thellë në zemër,
Si rrënjë që shtrihen, si frymë që s'ndahen.

ENGJËJ ME MASKË

Para meje, si engjëj duken, të bardhë e të butë,
Me buzëqeshje që shtrijnë e fjalë që duken të kthjellëta.
Por sapo largohen, maskat bien në heshtje,
Dhe fjalët e fshehura shpërndahen si errësira në natë.

Përballë më falin shikime të ëmbla,
Si miq që më ndjekin në çdo hap të rrugës.
Por pas krahëve të mia, si erë e keqe,
Hedhin fjalë që helm i kthejnë, si gjemb mbi lule.

Më ndjekin si hije që prekin dritën,
Por unë e di, s'jam e verbër ndaj tyre.
Se syri i shpirtit sheh dhe përtej maskave,
Dhe ndjen aromën e vërtetë të zemrës së tyre.

Kështu qëndrojnë e qetë, mbi fjalët e hidhura,
Si një shkëmb që nuk thyhet nga dallgët e ashpra.
Se zemra ime nuk mund të preket nga helmi,
Nga ata që përjashta janë engjëj, por brenda janë shkrepa.

DARKA E TRADHTISË

Përpara syve, vëllezër, duar që shtrihen,
Përpara fjalëve, buzëqeshje që mashtrojnë.
Por prapa shpinës, duar që vjedhin,
Shkruajnë dhe nënshkruajnë, mbi pasuritë që nuk i
takojnë.

Në banka flasin për hipoteka,
Me emra të falsifikuar, pa ndjenjë turpi.
Të shitur për një nënshkrim, një shans për pushtet,
Por pas çdo veprimi, mbetet hidhërimi dhe dënimi.

Menduan se pasuria është një mall që mund të shitet,
Se zemra e vëllezërve mund të blihet.
Por kush tradhton gjakun, haron historinë,
Se kurrë nuk mbeten të pasur ata që ndajnë gënjeshtër.

Dita do të vijë kur sytë do të ndriçojnë,
Kur e vërteta do të shkëlqejë si dielli në mëngjes.
Dhe asnjë lloj pasurie nuk do të ketë vlerë,
Përpara syve të atyre që shesin shpirtin për një copë
bukë.

PASURIA DHE SYRI I URITUR

Në shtërngata duar që nuk duan të lëshojnë,
Në zemra të ngushta që asnjëherë s'kanë kuptuar.
Se pasuria nuk është thjesht një thesar që mbrohet,
Por një trashëgimi që duhet ndarë dhe nderuar.

Ata që mbyllen në dhoma të errëta,
Nuk e kuptojnë se pasuria është dhuratë.
Ajo është rrugë e ndarë për secilin,
Një e drejtë që nuk mund të mbahet për vete, të fshehur.

Nuk janë pasuritë ato që na bëjnë të mëdhenj,
Por mundësia për të ndarë, për të pranuar njëri-tjetrin.
Se njeriu që nuk e njeh pasurinë e tjetrit,
Është ai që harron se dashuria nuk ka çmim.

Për çdo copë pasurie që mban për vete,
Ajo shndërrohet në një barrë që s'do të thotë asgjë.
Kur shpirti është i mbyllur dhe s'di të ndajë,
Cdo hap është një hidhërim që s'ndalet kurrë.

KAVALLI

Kavalli, një instrument i lashtë,
Nëpër male dhe lumej, ai kthehet.
Në duar të burrave me plis mbi kokë,
Një simfoni e jetës, me nota të thjeshta.

Përmes ajrit të pastër dhe të freskët,
Kavalli ngrihet si thirrje e shpirtit.
Rëndon mbi shpatet e dheut,
Si të na kujtojë pasionin dhe mundin.

Ata që e frynin me dashuri,
Të lidhur me natyrën dhe traditën.
I dhanë melodi çdo hapësire,
Dhe çdo ndjenjë bëhej këngë.

Me çdo frymëmarrje, çdo tingull,
Ata krijonin më shumë se një melodi.
Krijonin një lidhje, një jetë,
Një histori të pa thënë, të pashembullt.

Dhe kështu, kavalli vazhdon të këndojë,
Në duar të atyre që kujtojnë.
Një pasuri që nuk harrohet kurrë,
Një thesar i shenjtë, që jeton.

DJEPI

Djepi, ku ëndrrat u rritën të qeta,
Me ninullat e nënave, me këngët e luftës.
Ku fëmijët shqiptarë, të vegjël dhe të fortë,
Rriten me shpresë, me zemër të ngrohtë.

Në ato ninulla, historitë flisin,
Për trimëri, për atdhenë që duhej mbrojtur.
Për vargje të lashta që zgjoheshin natën,
Dhe për fjalë të urta që i mësonin fëmijët.

Djepi këndonte, nën tingujt e këngëve,
Si melodi të shenjta të një populli që nuk dorëzohet.
Dhe fëmijët, me sy të ngulur në ëndrra,
I dëgjonin, dhe përqaфонin guximin.

Ata u rritën me besim në tokën e shenjtë,
Me zërin e nënës, me forcat e burrave.
Këngët e trimërisë ishin ndihmësit e tyre,
Një udhërrëfyes, një dritë e pastër.

Dhe kështu, djepi bëri që fëmijët të rriten,
Një brez i fuqishëm, i papërkulur.
Një brez që do të mbante nderin dhe lavdinë,
Të lindur nga ninullat e dikurshme.

MAGJIA DHE SOFRA

Magja, burim i thjeshtësisë dhe ngrohtësisë,
Ajo që mbante çdo shpirt të ngushëlluar.
Në zemrën e shtëpisë, nën hijen e stuhive,
Përgatitej buka, ushqimi që mbante jetën.

Në atë vatra e ngrohtë, me dru që digjej ngadalë,
Gjithçka përgatitej me dorë, si një ritual i shenjtë.
Me miellin e gati për t'u shkrirë,
Dhe ujë të pastër, që shkrinte çdo shqetësim.

Magja, një vend ku ndodhnin mrekulli,
Këtu fëmijët rreth saj, të ulur me buzëqeshje.
Ndërsa gratë, me duar të forta dhe të dashura,
I jepnin jetës aromën e bukës që rritej.

Në ajër fluturonte një erë e butë,
E ngrohtë, e shkrirë me historitë e ditëve të kaluara.
Buka që ngrihej, shenjë e punës dhe e dashurisë,
Në magjën që fuste jetën në çdo copëza druri.

Kjo magje, e vjetër dhe e urtë,
Na lidhte me një traditë të thjeshtë, por të shenjtë.
Në çdo kafshatë, një histori, një kujtim,
Një shenjë e asaj që na mbante të bashkuar.

BORA BALAJ

Bora Krasniqi Balaj lindi më 29 gusht 1970 në Pejë. Shkollën fillore e mbaroi në fshatin Poqestë dhe në



Gorazhdec.

Të mesmen
ne Gjinnazin
”Bedri

Pejani” në

qytetin e

Pejës. Në Pejë

mbaroi edhe

Shkollën e

Lartë

Ekonomike.

Më pas

studimet e

dizajnit dhe të

modës i

mbaroi në

Tiranë për të

vijuar me

studimet për Diplomaci ndërkombëtare në Prishtinë.

Hulumtimet për etnografi i filloi që mbas lufte duke mbledhur dhe studiuar veshjet popullore shqiptare në Kosovë dhe në trojet tjera etnike shqiptare duke organizuar edhe shumë promovime dhe ekspozita të ndryshme brenda dhe jashtë vendit. Krijoi kompanin “Borafashion” në vitin 2003 në Gjakovë ku ofroi studime në fushën e modës dhe

shërbime për klient duke vazhduar të kontribuojë për kulturën e qytetit të saj. Me poezi merret që në fëmijëri.

Ka botuar veprat letrare “Zogu pa çerdhe”, poezi, Tiranë, 1997 “Loti në sy”, poezi, Prishtinë, 2003 “Veshje tradicionale shqiptare në Kosovë”, Etnografi, Gjakovë, 2009 dhe Romani “Heshtja” 2020. Roman i përkthyer në 4 gjuhë të huaja, dhe përmbledhja me poezi “Udhetim në kohë në 2024, Prishtinë.

Ky është libri i gjashtë nga autorja Bora Balaj .